



*This project is funded by  
the European Union*



## UDHËZUES

MBI

### PJESËMARRJEN NË DISTANCË NË PARLAMENTIN E DYTË RURAL SHQIPTAR 4-5 MARS 2021

#### Përse shërben ky udhëzues?

Ky udhëzues shërben për të koordinuar përpjekjet e organizatorëve dhe mbështetësve të Parlamentit të dytë Rural Shqiptar (PRSH2) me qëllimin final mundësimin e pjesëmarrjes në këtë event të fermerëve dhe grupeve të interesit në nivel vendor, me fokus të veçantë në zonat e largëta rurale dhe ato me akses të kufizuar në internet dhe pajisje teknologjike.

PRSH 2 do të organizohet në formatin hybrid duke kombinuar praninë fizike me pjesëmarrjen në distancë, në respekt të masave mbrojtëse anti-COVID 19. Ky kombinim i pjesëmarrjes do të bëhet i mundur nëpërmjet përdorimit të teknologjisë Hy-Flex.

Lidhja e aktorëve të interesit në nivel vendor - fermerëve, të rinjve, grave, grupeve prodhuese, njësi administrative, grupeve komunitare, organizatave të shoqërisë civile, e çdo banori të zonave rurale, etj – kryesisht në zonat me qasje të kufizuar në internet dhe pajisje teknologjike – me eventin e Parlamentit të dytë Rural Shqiptar (PRSH) do të bëhet nëpërmjet Qelizave Komunitare Lokale.

#### Çfarë është metodologjia Hy-Flex?

Metodologjia Hy-Flex (Hybrid Flexibility), megjithëse me zanafillë të hershme, ka gjetur përdorim të gjerë në kushtet e pandemisë dhe distancimit social që ajo solli, si dhe të izolimit gjeografik. Fjala “Hybrid” shpreh kombinimin e dy mundësive të pjesëmarrjes, të cilat do të përdoren gjatë zhvillimit të PRSH 2. Ato përfshijnë praninë fizike dhe atë virtuale (në distancë). Ndërsa “Flexibility” nënkupton që pjesëmarrësve do t’u ofrohet mundësia që të jenë fizikisht në event (në ambientet e Universitetit Bujqësor të Tiranës) ose ta ndjekin atë online, duke përdorur “qelizat komunitare lokale” funksioni i të cilave do të sqarohet në vijim.

**Çfarë janë qelizat komunitare lokale?** Qelizat Komunitare Lokale janë njësi mundësuese për pjesëmarrjen virtuale në PRSH 2 duke përdorur metodologjinë Hy-Flex (Hybrid Flexibility). Më thjesht, ato janë një takim i një numri të vogël aktorësh vendor deri në 10 persona që ndjekin së bashku në distancë PRSH2 dhe janë pjesë aktive e diskutimeve dhe programit dy ditor të PRSH 2. Qeliza Komunitare Lokale do të lehtësohet nga Koordinatorin e saj.

#### Cili është qëllimi?

Krijimi i Qelizave Komunitare Lokale synon të mundësojë dhe maksimizojë pjesëmarrjen virtuale të komuniteteve rurale në PRSH2 nëpërmjet sigurimit të mjeteve dixhitale dhe aksesit në internet si dhe masave mbrojtëse anti-COVID-19. Kjo do të mundësojë takime fizike në grupe të vogla, deri në 10 persona, sikurse rregullat mbrojtëse të pandemisë kërkojnë.





*This project is funded by  
the European Union*



Nevoja për qelizat komunitare lokale diktohet nga organizimi i Parlamentit rural shqiptar në kushtet e pandemisë, dhe reflekton përpjekjen e ANRD për të gjetur instrumente inovativ për të lidhur grupet e interesit në nivel vendor, me fokus të veçantë ato grupe që nuk kanë akses për t'u lidhur me procese zhvillimore dhe vendimmarrëse që ndikojnë jetët e tyre. Qelizat komunitare lokale – ose njësitë e pjesëmarrjes virtuale – do të lidhin platformën dhe eventin e PRSH 2 me fermerët dhe të tjerë grupe interesi aktiv të komuniteteve rurale, dhe do të mundësojë ata të artikulojnë nevojat, interesat dhe aspiratat e tyre.

Nëpërmjet Qelizave komunitare lokale çdo banor a përfaqësues i grupeve të ndryshëm të interesit, do të lidhet me procesin dhe do mund të shprehë opinionin e vet, pavarësisht rrethanave kohore apo hapësinore, duke qenë në këtë mënyrë pjesëmarrës aktiv i Parlamentit.

### **Ku do të krijohen Qelizat Komunitare Lokale?**

Minimalisht do të krijohet një qelizë komunitare në secilën prej 61 bashkive të vendit, dhe me ndihmën e mbështetësve dhe dashamirësve të çështjes së zhvillimit rural do të bëhen përpjekje për të rritur numrin e tyre nëpër njësitë administrative të vetëqeverisjes vendore.

### **Pjesëmarrësit e Qelizave Komunitare Lokale?**

Pjesëmarrësit e qelizave komunitare lokale janë të gjithë aktorët e interesit në nivel vendor. Një listë jo shteruese e tyre është si vijon:

- ✓ Fermerë, veçanërisht fermerët e vegjël;
- ✓ Të rinj të zonave rurale, nxënës dhe staf mësimor të shkollave të mesme, studentë, etj.
- ✓ Gra të zonave rurale, grupe prodhuese të grave, klastera të ndryshëm të grave në bujqësi;
- ✓ Sipërmarrës ruralë;
- ✓ Banorë të zonave rurale, grupe komunitare, OSHC-të vendore; qytetarë aktiv të komuniteteve vendore;
- ✓ Përfaqësues të bashkive, njësi administrative, drejtorive të bujqësisë, Agropikave, ekstensione e të tjerë nga sektori publik;
- ✓ Përfaqësues të sektorit privat, e të tjerë dashamirës dhe mbështetës të çështjes së zhvillimit rural; etj.

### **Kush do të administrojë Qelizat?**

Koordinimi i çdo qelize do të bëhet nga Koordinatori i saj, i cili do të bëjë të mundur lidhjen ndërmjet PRSH 2 dhe pjesëmarrësve të Qelizës për të siguruar një pjesëmarrje të rregullt dhe aktive të aktorëve vendor përgjatë gjithë programit të PRSH2.

Në rolin e Koordinatorit do të përfshihen staf dhe aktivistë të organizatave anëtare të ANRD në terren si dhe të organizatave të tjera vendore, aktivistë dhe lider vendorë me aftësi komunikuese, animuese dhe menaxhuese për të administruar qelizat në komunitetet lokale përkatëse.





This project is funded by  
the European Union



## Kërkesat standarde për krijimin e qelizës




Figura 1: Skicë e një qelize komunitare lokale e PRSH2

Hapësira duhet të pajiset domosdoshmërisht me 10 ose më shumë karrige, 1 laptop + 1 projektor dhe lidhje të qëndrueshme interneti si dhe vizibilitet për PRSH 2.

Pjesëmarrësve do t'u ofrohet kafe, çaj, ujë dhe drekë e lehtë përgjatë pjesëmarrjes së tyre në distancë dhe në përputhje me programin e PRSH2.

## Përgjegjësitë e Kordinatorit të Qelizave Komunitare Lokale për Pjesëmarrjen Virtuale në PRSH2

Lehtësuesit do të përzgjidhen nga ANRD në konsultim me organizatat anëtare dhe të tjerë partnerë vendorë. Koordinatorin i përzgjedhur do të ketë përgjegjësitë e mëposhtme:

- ✓ Të marrë pjesë në sesionin online orientues që do të organizohet nga Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural në javën e fundit të muajit shkurt 2021.
- ✓ Të jetë i pranishëm në qelizën për pjesëmarrjen virtuale gjatë të dy ditëve të programit të PRSH 2 (4-5 mars 2021) në përputhje me oraret e aktivitetit.
- ✓ Të sigurojë pajisjen e sallës me laptop, kamera dhe mikrofon funksional si edhe pajisje projektori.
- ✓ Të jetë përgjegjës për menaxhimin e hapësirës në përputhje me rregullat e distancimit social dhe pajisjen me maska dhe dezinfektues duarsh për të gjithë pjesëmarrësit.



*This project is funded by  
the European Union*



**RRJETËZIM**  
PËR ZHVILLIMIN RURAL  
ME PJESËMARRJE

- ✓ Të sigurojë pjesëmarrje të vazhdueshme të aktorëve vendorë, me një numër maksimal prej 10 personash dhe numër minimal prej 4 personash të pranishëm në hapësirë në të njëjtën kohë përgjatë dy ditëve të aktivitetit.
- ✓ Të koordinojë ardhjen në fasha të ndryshme kohe të pjesëmarrësve në qelizën lokale të PRSH 2, duke garantuar një pjesëmarrje të qëndrueshme në mënyrë që salla të mos jetë asnjëherë bosh apo të tejkalojë limitin e kërkuar në përputhje me rregullat e mbrojtjes nga Covid-19.
- ✓ Të përpiqet për garantimin e një pjesëmarrje të plotë (maksimumi 10 persona) veçanërisht në kuvendimet në grupe të vogla në dy raundet.
- ✓ Të sigurojë ofrimin e kafes, ujit, çajit dhe drekës për pjesëmarrësit në qelizë në oraret e pushimit sipas programit të PRSH2.
- ✓ Të nxisë audiencën në qelizë që të jenë aktive dhe kontribuuese duke bërë pyetje, ndarë shqetësime, nevoja dhe përvoja, në mënyrë të unifikuar nëpërmjet koordinatorit të qelizës.
- ✓ Të regjistrojë të gjithë pjesëmarrësit dhe të raportojë listë-prezencën e tyre në ANRD.
- ✓ Të promovojë PRSH 2 dhe të vendosë elementët e vizibilitetit të PRSH 2 sipas udhëzimeve të ANRD.

### Garantimi i sigurisë anti-COVID nga ana e Kordinatorëve të Qelizave Komunitare Lokale për Pjesëmarrjen Virtuale në PRSH2

Të gjithë koordinorët do t'i nënshtrohen një trajnimit të shkurtër të përbashkët online, të organizuar nga organizatorët e PRSH2, në lidhje me menaxhimin e situatës së kushteve të sigurisë anti-COVID19. Gjatë trajnimit do t'ju shpjegohen me hollësi përgjegjësitë për garantimin e sigurisë anti-COVID19 në lidhje me sigurimin e distancave, numrit maksimal të pjesëmarrësve në ambientet e brendshme të qelizave dhe mbajtja e maskave. Këto rregulla sigurie për asnjë lloj arsyeje nuk duhen të shkelen. Në rastet kur ka prani të shtuar përtej normave të pjesëmarrësve, përveç garantimit të masave të përmendura më sipër:

- ✓ Koordinatori duhet të marrë masa jo vetëm për të pajisur personalisht pjesëmarrësit me maska dhe dezinfektues por edhe që në asnjë çast të mos paraqitet edhe vetë pa mjete mbrojtëse.
- ✓ Koordinatori duhet të sigurojë praninë brenda qelizës maksimalisht të 10 personave duke u kujdesur personalisht për zëvendësimin e personave që janë prej kohësh të pranishëm brenda, me personat e ardhur rishtas.
- ✓ Ky proces do të bazohet në mirëkuptimin e dyanshëm dhe në rast mungese mirëkuptimi, personat e sapoardhur nuk do të lejohen të qëndrojnë në ambientet ku tejkalohet numri maksimal i të pranishmëve.
- ✓ Koordinatori në përputhje me programin e eventit do të përpiqet t'u garantojë të gjithë të interesuarve pjesëmarrjen, por do të konsiderojë dhe mbajë si parësore çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes anti-COVID 19.



*This project is funded by  
the European Union*



### **Kohëzgjatja:**

Qeliza për pjesëmarrjen virtuale do të qëndrojë e hapur dhe do mirëpresë pjesëmarrësit përgjatë datave 4-5 mars 2021, nga ora 09:00 – 16:00 (dita I) dhe nga ora 09:00 – 13:00 (dita II).

### **Promovimi:**

Pjesëmarrësit në qelizë, individualisht dhe në grup inkurajohen që të bëjnë foto për postim në rrjetet sociale duke përdorur hashtagun **#ShqipëriaRurale!**

Për më shumë informacion kontaktoni: [info@anrd.al](mailto:info@anrd.al)